

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“KUKA & PARTNERS” SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 04.08.2020, ne të nënshkruarit:

1. **MURAT KUKA**, lindur ne Kosove, me 20.08.1968, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numer Pasaporte P01649905
2. **ARDIAN MUKA**, lindur ne Durres-Shqiperi, me 05.08.1967, qytetar Shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numer karte identiteti G70805164E
3. **ISUF MORINA**, lindur ne Durres-Shqiperi, me 07.06.1965, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numer identifikimi G50607044J

themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin

“KUKA & PARTNERS” SHPK

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Neni 2: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Lagjja 4, Rruga Iljaz Reka, Pallati “Rajfi”, Kati 2-te, Durres, Shqiperi.

Shoqeria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashte vendit.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Veprimtari ne fushen e ndërtimit dhe rikonstruksionit te objekteve civile, turistike, shëndetsore, kulturore, tregtare, sportive, industriale, vepra kullimi, ujitje, rrugë, kanalizime, punime infrastrukture, porte, asistencë dhe ekspertizë teknike, etj. Punime te tokes dhe ndertime muresh, ndertim, kompletim te impianteve dhe perfundim te tyre, vepra restaurimi, ndertim te asfaltit.
- Ne fushen e turizmit shoqeria do te kryeje studimin, projektimin, konsulencen , sipermarrjen zbatuese dhe investimin, sipas rastit per realizimin me fonde publike dhe jopublike te infrastruktures dhe te pjeseve perberese te saj per shfrytezim njerezor me karakter pushues, argetues, edukues, dhe kurues, te burimeve natyrore , kulturore mjedisore kurative, te Shqiperise , per realizimin e hotelerise, fshate turistike, qendra turistike e te tjera dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesoreve te nevojshem si bar-bufe restorante , qendra estetike, palestra fitnesi , njesi te shitjeve te konfeksioneve dhe prodhimeve ushqimore e industriale e te tjera te kesaj natyre.
- Tregtim i materialeve te ndertimit brenda dhe jashte vendit per vete dhe per te trete, ndertim te impjanteve dhe te stabilimenteve per prodhimin dhe furnizimin e lendeve te para dhe te materialeve te ndertimit te cdo lloji.
- Te kryeje blerjen, shitjen, ndertimin, administrimin dhe shkembimin e pasurise se palevizshme.
- Tregtim dhe prodhim komponente prej betoni, parafabrikate.

- Studime beshmerie, Studime te ndikimit ne mjedis, drejtim punimesh, supervision
- Tregtim me shumice e pakice, te artikujve te ndryshem industriale, etj.
- Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj(sipas nenit 7 te Ligjit nr.9901,dt.14.04-08).

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është **100.000 (njeqindmije)** Leke i ndarë në 3 kuota.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

MURAT KUKA eshte zoteruese i 1 kuote, me 56% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 56.000 leke.

ARDIAN MUKA eshte zoterues i 1 kuote, me 22% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 22.000 leke.

ISUF MORINA eshte zoterues i 1 kuote, me 22% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 22.000 leke.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. ARDIAN MUKA** për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti. Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakeve të Shoqërisë

MURAT KUKA



ISUF MORINA



ARDIAN MUKA

